REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.5.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË KULTURËS RINISË DHE SPORTIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga, Blerina Krasniqi (udhëheqëse e ekipit), Veton Misiri dhe Valbona Tolaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 10

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 17

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 34

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 35

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 37


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit dërguar në Tetor 2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

<u>Opinion të kualifikuar me Theksim të Çështjes</u>

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion, pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Kualifikimi i Opinionit dhe Theksimi i Çështjes i pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar klasifikimin e shpenzimeve dhe vlerësimin e pasurisë.	Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Kualifikim të Opinionit dhe Theksimin e Çështjes në 2015 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar prezantim të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2016 (shih nënkapitullin 1.3).
Procesi i përgatitjes së PVF-ve është menaxhuar dobët me disa gabime financiare dhe të prezantimit, të idenitifkuara gjatë auditimit.	Ministri duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PVF 2016 të inkoporojë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv dhe deklarata për PVF-të të nënshkruhet vetëm pasi janë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih nënkapitullin 1.4).
Procesi i vetëvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk janë adresuar ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.	Ministri duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetëvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet 3dhe 4).
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta.	Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ (shih çështjet 5, 6 dhe 7).
Në shumicën e fushave të kontrolleve të brendshme ekzistojnë dobësi. Këto kanë të bëjnë me sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë prokurimin , subvencionet dhe transferet si dhe pagat e meditjet.	Ministri duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të prokurimit dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet nga 8 deri 24).

Përgjigja e Ministrit – Auditimi 2015

Ministri i ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti implementojë rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i Kualifikuar me Theksim të Çështjes

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion, pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme); Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime); dhe Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 249,313€ janë paguar nga buxheti për subvencione dhe transfere. Këto shpenzime kishin të bënin me pagesën e të angazhuarve me marrveshje për shërbime të veçanta; Nga mallrat dhe shërbimet, 52,232€ janë paguar për subvencione dhe transfere dhe 7,107€ për paga dhe mëditje; Nga pagat dhe mëditjet, janë paguar 69,671€ për mallra dhe shërbime. Nuk ka qenë i mundur korigjimi i këtyre gabimeve sepse shpenzimi në SIMFK tashmë ka ndodhur. E gjithë kjo ka rezultuar me keqklasifikim në mes të kategorive ekonomike dhe gabime financiare në Pasqyrat Vjetore Financiare në vlerë prej 378,323€. Vlera e këtyre gabimeve e tejkalon vlerën e përcaktuar të materialitetit dhe për këtë arsye e kemi kualifikuar opinionin.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se mungesa e një qasje sistematike për të konfirmuar vlerën e pasurive financiare dhe atyre jofinanciare nga ana e Ministrisë, ka rezultuar në një pasiguri mbi vlerën e vërtetë të pasurive neto. Këto çështje kanë ndodhur sepse Ministria nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për vlerësimin e gjithë pasurisë financiare të saj, nuk ishte bërë inventarizimi dhe përshtatja me regjistrat e pasurisë dhe shumica e pasurive të Institucioneve vartëse me vlerë nën 1,000€, nuk ishin të përfshira në regjistra. Opinioni jonë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PFV

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 28/10/2015, janë identifikuar tri rreziqe domethënëse për PVF-të. Këto janë rreziqe të keqdeklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Njëri prej tyre kishte të bënte me klasifikimin e shpenzimeve dhe tjetri me vlerësimin e pasurisë siç është theksuar në opinion e paraqitur më lart. Këto rreziqe janë materializuar sepse nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura nga menaxhmenti për ti adresuar rreziqet e paraqitura.

Rreziku i tretë domethënës që ka të bëjë me trajtimin e mjeteve financiare të transferuara në llogaritë komerciale të Institucioneve vartëse, nuk është materializuar sepse gjatë vitit menaxhmenti ka tejkaluar çështjet që ndërlidheshin me menaxhimin e tyre.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MKRS kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën MF Nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, (me ndryshime dhe plotësime) dhe
- Kërkesat tjera (përfshirë kërkesat e buxhetit, raportet tremujore, pasqyrat nëntëmujore si dhe kërkesat në lidhje me planifikimin e prokurimit).

Në kontekst të PVF-ve, përveç çështjeve të paraqitura tek rreziqet domethënëse dhe tek opinioni i auditimit, ne nuk kemi çështje tjera për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 15.12.2015, në lidhje me kornizën raportuese nuk ishin adresuar nga Menaxhmenti, dhe një numër i gabimeve kanë ndodhur në draft PVF. Ne kemi dhënë sugjerimet tona për përmirësimet e nevojshme të Draft PVF-ve për pozicionet qe kanë mundur të korrigjohen dhe ato janë zbatuar.

Të gjeturat më lart tregojnë që përgatitja e PVF -ve është menaxhuar në mënyrë të dobët.

DEKLARATA E BËRË NGA ZKA DHE ZKF

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet jo e plotë dhe e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale dhe çështje tjera.

Rekomandimi

Rekomandimi 1 **Prioritet i lartë –** Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Kualifikim të Opinionit dhe Theksimin e Çështjes në 2015 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar prezantim të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2016.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MKRS që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm ; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MKRS veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar nga Ministria, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi i auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, nuk janë të vendosura në mënyrë adekuate.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të MKRS-së kishte rezultuar me 24 rekomandime. MKRS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen ato.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 5 rekomandime janë implementuar; 5 janë adresuar por nuk janë implementuar plotësisht, dhe 14 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura

Vetëm një numër i vogël i rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar, sepse MKRS nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të AP-së.

Rreziku

Mos implemlementimi i rekomandimeve ka ndikuar që në vazhdimësi të ketë dobësi të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, si subvencione dhe transfere, investime kapitale dhe paga dhe mëditje, e që rezultojnë në:

- Mos-efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe praktika jo të mira të qeverisjes;
- Mos-efikasitet në menaxhimin e projekteve kapitale dhe vonesa në kryerjen e punëve;
- Mosaplikim i rregullores për dhënien dhe arsyetimin e subvencioneve;
- Vazhdimin e angazhimit të punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit;
- Mangësi në menaxhimin e të hyrave dhe kompensimin e të angazhuarve nga Institucionet vartëse të Ministrisë;
- Keqklasifikim të shpenzimeve; si dhe
- Paraqitje jo të drejtë të pasurive në PVF.

Rekomandimi 3

Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Barierat që pengojnë implementimin e rekomandimeve duhet të raportohen te Ministri dhe të përcaktohen dhe ndërmerren masat e nevojshme për adresimin e tyre.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MKRS më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 4 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, ne i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Nuk janë vendosur procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.2;

2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk janë të vendosura, pasi që nuk ekziston një plan strategjik në nivel të organizatës. Çështjet e monitorimit po ashtu janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.5.3;

3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga MKRS dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion.

Lista kontrolluese në përgjithësi nuk ofronte përgjigje të plota dhe konkrete në shumicën e pyetjeve. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda MKRS për rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe faktin se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku	Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
Rekomandimi 4	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim i procesit të plotësimit të listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi, në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë përgjigjeve në pyetjet e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MKRS operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies

MKRS ka 18 Institucione vartëse nën menaxhimin e saj (përfshirë edhe Bibliotekën Kombëtare të Kosovës-BKK). Përveç sigurimit të buxhetit për funksionimin e tyre, Ministria i mbështet financiarisht edhe projektet e tyre të ndryshme kulturore, rinore, sportive dhe ato të trashëgimisë. Këto subvencione pritet që të arsyetohen me raporte dhe dëshmi mbështetëse. Mirëpo një gjë e tillë nuk ndodh për shumicën e projekteve, pasi që të njëjtat nuk arsyetohen me kohë dhe figurojnë si "avance" të hapura dhe si të tilla raportohen gabimisht në Pasqyra Financiare.

Çështja 5 - Proceset e llogaridhënies – Prioriteti i lartë

E gjetura Proceset e llogaridhënies dhe raportimit shfaqin një numër dobësish, të cilat zvogëlojnë efektivitetin e menaxhimit financiar në përgjithësi. Kjo ka ndodhur për shkak të paqartësisë në lidhje me obligimet raportuese të Institucioneve vartëse ndaj Ministrisë dhe obligimeve tjera reciproke. Si rezultat i kësaj llogaridhënia dhe përgjegjësitë përcjellëse për raportim janë të kufizuara dhe nuk zbatohen në mënyrë efektive. Llogaridhënia efektive kërkon që të qartësohen rolet dhe përgjegjësitë.

Rreziku Mungesa e qartësisë ligjore rreth obligimeve reciproke të Institucioneve vartëse dhe Ministrisë, kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët e kanë reduktuar efektivitetin e menaxhimit financiar brenda MKRS. Kjo rezulton me dobësi në procesin buxhetor dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo rrit rrezikun për shpenzime të parregullta.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të iniciojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit të vendosura ndaj institucioneve vartëse si dhe të siguroj aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat specifike.

2.5.2 Menaxhimi i rrezikut

Të gjitha Organizatat Buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara të MFK-së dhe praktikat e mira të menaxhimit, kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 6 - Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – Prioriteti i lartë

E gjetura Pyetësori i vetëvlerësimit i plotësuar nga MKRS ka vërtetuar mungesën e sistemeve adekuate të menaxhimit të rrezikut brenda organizatës. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se nuk ishin ndërmarrë masat për hartimin e një regjistri të rreziqeve dhe menaxhimin e aktiviteteve për azhurnimin e vazhdueshëm dhe zbutjen e atyre rreziqeve. Adresimi i kësaj çështje është inicuar pas diskutimeve që ekipi i auditimit ka pasur me zyrtarët e ministrisë.

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të ndikojë në mosadresimin me kohë të rreziqeve duke reduktuar kështu efektivitetin dhe duke ndikuar në mos përmbushjen e objektivave dhe planeve të synuara të Ministrisë.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e një qasje të re të menaxhimit e cila do të adresonte rreziqet potenciale që mund të pengojnë arritjen e objektivave të Ministrisë. Hartimi i një regjistri të rreziqeve potenciale do të ishte hap i parë për tu pasuar më tej me veprimet e nevojshme për menaxhimin/zbutjen e këtyre rreziqeve potenciale.

2.5.3 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 7 – Dobësi në Kontrollet Menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar ka nxjerrë në pah një numër dobësish, të cilat zvogëlojnë efektivitetin e menaxhimit financiar në përgjithësi. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet si dhe nuk lë gjurmë që dokumentojnë shqyrtimin e tyre nga menaxhmenti i lartë.

Rreziku Cilësia jo e mirë e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë e redukton aftësinë për të menaxhuar aktivitetet në mënyrë pro aktive dhe ul efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për ti adresuar ato.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2016.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MKRS dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi.

Çështja 8 - Sistemi i auditimit të brendshëm – Prioritet i lartë

E gjetura

Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me këto operacione brenda MKRS:

1. Vetëm dy prej pesë auditimeve të planifikuara nga NJAB janë kryer gjatë 2015. Kjo ka ndodhur pasi që menaxhmenti kishte kërkuar gjashtë auditime tjera jashtë planit vjetor; dhe
2. Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë implementuar vetëm në një numër të vogël të rasteve nga ana e menaxhmentit dhe nuk ishin përgatitur plane të veprimit për adresimin e rekomandimeve të NJAB.

Rreziku

Një program i papërfunduar i NjAB ndikon në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive të mundshme në kontrolle dhe humbet mundësia për përmirësime. Kjo gjithashtu, zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit për funksionimin e sistemeve financiare. Si pasojë, rritet mundësia për jo efikasitet operativ dhe humbje financiare.

Rekomandimi 8

Ministri duhet ti kushtoj rëndësi më të madhe sistemit të auditimit të brendshëm duke ju ofruar përkrahje të vazhdueshme dhe të nevojshme për punë efektive. KA duhet të rishikojë në mënyrë më kritike planet e NjAB (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe zbatimin e planeve të veprimit.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket MKRS, realizimi i projekteve kapitale mbetet shqetësim, ku nuk janë duke u zbatuar afatet, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat në përfundim të projekteve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar Ministrinë që mos të pësojë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, menaxhimi i subvencioneve për përkrahjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të Institucioneve vartëse, në përkrahjën financiare të përfituesve dhe tek menaxhimi i pasurisë.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MKRS, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final1	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**21,800,307**	**19,248,065**	**18,874,393**	**16,780,838**	**15,515,293**
Granti i Qeverisë -Buxheti	21,756,687	17,646,491	17,598,684	16,378,177	14,356,009
Të bartura nga viti paraprak[2] –	-	26,119	6,003	9,16	1,856
Të hyrat vetjake[3]	43,620	43,620	4,224	4,869	12,179
Donacionet e jashtme	-	1,531,835	1,265,482	388,375	1,145,248

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[2] Të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.
[3] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Buxheti final është më i vogël se buxheti fillestar për 2,552,242€. Ky zvogëlim ishte rezultat i ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit, me vendime të qeverisë dhe përfshirjes së mjeteve nga donacionet dhe të hyrat vetanake në buxhet. Zvogëlim domethënës të buxhetit kishte tek Investimet kapitale për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të mjeteve, duke qenë se disa projekte madhore nuk kishin mundur të inicohen. Poashtu edhe tek pagat dhe mëditjet kishte zvogëlim të buxhetit. Përderisa kishte rritje te ndjeshme të buxhetit tek mallrat dhe shërbimet dhe subvencionet e transferet.

Në vitin 2015, MKRS ka përdorur 98% të buxhetit final ose 18,874,393€, me një përmirësim prej 13% krahasuar me vitin 2014. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**21,800,307**	**19,248,065**	**18,874,393**	**16,780,838**	**15,515,293**
Pagat dhe Mëditjet	3,503,344	3,420,809	3,390,057	3,156,936	2,456,053
Mallrat dhe Shërbimet	947,406	1,878,093	1,552,779	1,235,932	1,236,386
Shërbimet komunale	294,323	294,309	292,866	275,099	178,029
Subvencionet dhe Transferet	6,006,550	7,403,137	7,387,185	5,803,017	5,869,321
Investimet Kapitale	11,048,684	6,251,717	6,251,506	6,309,852	5,775,501

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Zvogëlimi i buxhetit për paga dhe mëditje për 82,535€ është rezultat zvogëlimit me rastin e rishikimit të buxhetit në vlerë 212,825€, dhe rritjes nga donacionet 94,614€, të hyrave vetanake 14,400€ dhe rritjes së mëvonshme me vendim të Qeverisë prej 21,276€; Realizimi i buxhetit ishte 99%.
- Kategoria e mallrave dhe shërbimeve kishte rritje prej 98% në krahasim me buxhetin fillestar, derisa realizimi në fund ishte në nivelin 82% e buxhetit final. Kjo kategori e shpenzimeve nuk ishte menaxhuar mirë, pasi që në fund të vitit kishte një suficit prej 288,064€, ndërsa obligimet e papaguara (të shpalosura në PVF) nga kjo kategori ishin 135,781€.
- Buxheti final i Investimeve kapitale ishte më i ulët për 4,796,967€. Fillimisht kishte një rritje me rishikim prej 769,735€, dhe 100,000€ të tjera ishin shtuar me vendim të qeverisë. Pastaj një transfer nga Investimet kapitale në linjen subvencione dhe transfere në vlerë 998,780€ dhe një shkurtim në vlerë 4,667,922€ me vendim të qeverisë. Edhe pse buxheti final ishte shpenzuar afër 100%, kjo nuk paraqet një performancë të mirë buxhetore duke marrë parasysh se shkurtimi i buxhetit ishte bërë për shkak se Ministria nuk ka qenë në gjendje ta shpenzoj, dhe se në tre muajt e fundit të vitit janë realizuar rreth 76% të shpenzimeve vjetore në këtë kategori.

- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte më i lartë për 1,396,587€, krahasuar me atë fillestar, derisa ishte shpenzuar rreth 99.8% e kësaj shume. Edhe pse lartësia e ekzekutimit ishte e kënaqshme, duhet të potencohet fakti se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve nga kjo kategori ekonomike është keqklasifikuar, si pasojë e planifikimit jo të saktë të buxhetit dhe mungesës së mjeteve në kategori tjera.

Çështja 9 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë

E gjetura Pavarësisht ekzekutimit të lartë të buxhetit, tek kategoria e investimeve kapitale, dinamika e ekzekutimit të buxhetit nuk ishte në harmoni me rrjedhën e planifikuar të parasë pasi që rreth 76% e buxhetit është shpenzuar në tremujorin e fundit të vitit. Poashtu për shkak të pamundësisë së realizimit të projekteve kapitale një pjesë e konsiderueshme e buxhetit është marrë nga Qeveria në fund të vitit. Në mos realizimin e projekteve të planifikuara kanë ndikuar edhe faktorë të jashtëm, që nuk janë nën ndikimin e Ministrisë (si çështje të definimit të pronësisë së parcelave ku janë paraparë ndërtimet, lejet e ndërtimit, procedurat e ankimimit, vonesat nga kontraktorët etj).

Rreziku Mos realizimi i projekteve kapitale me kohë, ka rezultuar me mospërmushje të planit dhe synimeve të Ministrisë. Realizimi i shpenzimeve kapitale në pjesën e fundit të vitit ndikon që të shtohet vëllimi i pagesave, dhe si pasojë mund të ndodh që pagesat të procesohen pa kontrolle adekuate dhe të rezultojnë në parregullsi eventuale.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë që bëhen analiza të vazhdueshme mbi rrjedhën e realizimit të buxhetit në mënyrë që shpenzimet të bëhen në përputhje me planin buxhetor dhe me qëllim të shmangjes së parregullësive eventuale si rezultat i devijimeve nga plani. Gjatë planifikimit të investimeve kapitale duhet të mirren parasysh edhe faktorët e jashtëm ndikues.

3.4 Prokurimi

MKRS bazuar në planin vjetor të prokurimit kishte zhvilluar procedura të prokurimit dhe kishte nënshkruar kontrata për vitin 2015 me vlerë të përgjithshme rreth 1,173,966€. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndështkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Ne kemi analizuar ndërlidhjen e projekteve kapitale me Programin për Investime Kapitale (PIP) dhe me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Poashtu kemi testuar rregullsinë e procedurave të

prokurimit. Një numër i konsiderueshëm i projekteve kapitale të parapara të realizohen gjatë vitit 2015 nuk ishin realizuar fare, ndërsa disa nga projektet e kontraktuara viteve të mëparshme kishin progres të ulët si pasojë e vonesave në realizimin e punimeve dhe planifikimeve jo të sakta të pozicioneve në paramasë.

Çështja 10 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioritet i lartë

E gjetura Nga shqyrtimi i 16 kontratave kemi identifikuar çështjet e mëposhtme:

Janë kryer pagesa për punë që nuk janë kryer për projektet në vijim:

- Për "Palestrën Sportive në Istog" rreth 84,579€" janë paguar për punët/pozicionet[4] e pakryera. Sipas zyrtarëve të ministrisë për këtë shumë OE ka kryer punë tjera si rezultat i shfaqjes së nevojës për më shumë sasi, në krahasim me sasinë e planifikuar në paramasë, për disa pozicione të caktuara si: armatura, fasada, sendviq panel etj. Mirëpo kjo nuk është mbështetur me dëshmi të dokumentuara; dhe

- Për "Palestrën Sportive në Deçan", disa nga pozicionet[5] e paguara nuk ishin përfunduar tërësisht.

Dhënia e kontratës OE të papërgjegjshëm - Në katër raste ishin shpërblyer me kontratë OE në mungesë të dëshmive adekuate në lidhje me kapacitetin teknik e profesional (kualifikimet e stafit dhe librezat valide të automjeteve). Këto kontrata ishin: "Renovimi i stadiumit R.L- Mitrovicë" në vlerë 138,131€, "Funksionalizimi i objektit në Kompleksin e IKMM" në vlerë 64,662€, "Renovimi i pjesërishëm i Teatrit-Gjilan"në vlerë 57,603€ dhe "Renovimi i Zyrave të QKK-së" në vlerë 13,830€.

Kontrata të paarsyeshme për shërbime - Në dy raste BKK kishte lidhur kontratë dhe kishte paguar 2,200€ për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe për çertifikimin e pagesave, përkundër faktit se për kryerjen e këtyre punëve obligohet Ministria dhe punëtorët e saj. Me rekomandimin tonë në Memorandumin e auditimit, këto pagesa ishin ndërprerë.

Keqklasifikim i shpenzimeve - Në tri raste, me vlerë të përbashkët prej 52,232€, pagesat e subvencioneve dhe transfereve ishin bërë nga mallrat dhe shërbimet.

[4] Punimet e pakryera kanë të bëjnë me instalimin e ngrohjes dhe të tubacionit, instalimin e elementeve të sanitarisë, vendosjen e dyerve, punët e ngjyrosjes, ndriquesit elektrik etj.
[5] Gjatë vizitës së palestres me datë 23.03.2016 kemi konstatuar se: se nuk ishte bërë montimi i gardhit të tribunave në vlerë prej 3,936€ dhe pozicionet e suvatimit dhe të ngjyrosjes nuk ishin përfunduar tërësisht.

Rreziku Pagesat për punët e papërfunduara janë në kundërshtim me normat ligjore dhe mund të ndikojnë që kontratat të mos përfundohen sipas kushteve të kontraktuara. Mos zbatimi i plotë i udhëzuesve përkatës të prokurimit mund të rezultojë në shërbime jo cilësore, në nënshkrimin e kontratave të cilat mund të mos zbatohen sipas standardeve të kërkuara, dhe vlerë e dobët për paranë e shpenzuar. Kjo po ashtu mund të rezultojë me pagesa potencialisht të parregullta dhe me humbje financiare për Ministrinë.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të inicojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kanë ndodhur pagesa për punët e pa realizuara, dhe pse nuk janë adresuar të gjitha kërkesat e prokurimit në rastet e përmendura. Rrjedhimisht, duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme dhe kontrolle të shtuara për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar.

Çështja 11 – Dobësitë jo-sistematike të prokurimit – Prioritet i lartë

E gjetura Nga rishikimi i 16 kontratave, kemi identifikuar se disa kontrolle menaxheriale ndaj aktiviteteve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në të gjitha rastet dhe kjo ka rezultuar si më poshtë:

- Ishte nënshkruar kontrata me "Kosova press" në vlerë 9,600€, bazuar në kuotimin e çmimit mirëpo dy nga tri ofertat kishin ofruar çmime më të larta se 10,000€ duke tejkaluar limitin e përcaktuar për këto procedura të prokurimit.
- Tek kontrata "Mirëmbajtja e softuerit Alef (softuer për menaxhimin e librave në BKK)"në vlerë 17,924€, vlera e kontratës tejkalonte vlerën e ofertës së fituesit për 429€.

Rreziku Rastet e identifikuara më lartë mund të rezultojnë në vlerë e dobët për paranë e shpenzuar. Në veçanti lidhja e kontratave me vlera më të larta se sa ofertat mund rezulton me obligime shtesë dhe pagesa të paarsyeshme.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim i rasteve të mësipërme për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen të vendosen kontrolle të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollet që operojnë në nivel të Ministrisë kanë të bëjnë me: autorizimin e listës së pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme; rishikimin e buxhetit për këtë kategori, barazimet me Thesarin etj.

Ne kemi testuar mostra të pagave nga Departmenti i Administratës Qëndrore, Institucioneve vartëse si dhe Bibliotekës Kombëtare për të verifikuar nëse ekziston pajtueshmëri midis listës së pagave me sistemin e payrollit, procedurat e rekrutimit dhe rregullsinë e dosjeve të personelit.

Çështja 12 – Kompenzime të parregullta për punonjësit e Ministrisë– Prioritet i Lartë

E gjetura

Pagesa nga kategori joadekuate - Në 30 raste, pagesa e punëve jashtë orarit ishte bërë nga buxheti për mallra dhe shërbime, derisa në 15 raste tjera pagesa e punëtorëve të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta ishte bërë nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Kjo ka qenë e shprehur kryesisht gjatë nëntë muajve të parë të vitit, derisa nga shtatori gjendja është përmirësuar;

Pagesa më të larta se pagat e përcaktuara në kontratë - 3 punonjës të rregullt dhe 26 të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta ishin paguar më shumë se sa kontratat e tyre. Vlera e përbashkët e mbipagesës për këta zyrtar ishte 9,450€.

Kompenzimi i punës jashtë orarit - Në 30 raste , ishte paguar puna jashtë orarit mirëpo mungonin aprovimet për punët shtesë jashtë orarit, nga ana e mbikëqyrësve të drejtëpërdrejtë. Poashtu nuk kishte evidenca relevante për të dëshmuar punët shtesë. Më tej, në tri raste ishin bërë pagesa për punë jashtë orarit në vlerë prej 900€, vetëm me aprovim të Sekretarit të Përgjithshëm duke mos përfillur kërkesat formale të aprovimit sipas kërkesave ligjore.

Vendimi për emërim (në mënyrë rekroaktive) për një periudhë që ka kaluar - Në Mars 2015 ishte marrë vendimi që një zyrtarë të emërohet dhe paguhet retroaktivisht nga Dhjetori 2014 si UD në pozitën Udhëheqës i një divizioni.

Të gjeturat e shpalosura më lartë kanë ndodhur sepse ka munguar monitorimi i mirëfilltë nga burimet njerëzore dhe nuk ishin aplikuar rregulloret e jashtme me konisistencë.

Rreziku Pagesat e pagave nga buxheti i kategorive të tjera dhe tejkalimi i shumave të kontratave mund të shkaktojnë keqklasifikim të informatave financiare dhe pagesa të parregullta. Parregullësitë e evidentuara në kompenzimin e punëve shtesë dhe vendimet për emërim dhe kompenzim për një periudhë të kaluar, mund të rezultojnë me pagesa të dyfishta dhe të parregullta.

Rekomandimi 12 Ministri duhet që të shqyrtoje rastet e identifikuara dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin e MKRS bëhet konform buxhetit të paraparë dhe në përputhje me kontratat e tyre. Puna jashtë orarit duhet të paguhet në pajtim me normat ligjore dhe vetëm pasi që kërkesa për punë të tillë të jetë aprovuar dhe dëshmuar në formë të dokumentuar.

Çështja 13 - Rekrutime të parregullta – Prioritet i mesëm

E gjetura Numri i të angazhuarve me kontrata për shërbime të veçanta në MKRS gjatë vitit 2015 ka arritur në 100. Përkundër vërejtjeve tona nga auditimet e kaluara, gjatë vitit 2015 ishin angazhuar 38 të tillë, pa aplikuar procedura të rekrutimit. Për shumicën nga ta nuk kishte as kërkesa nga departamentet përkatëse. Për më tepër, disa nga këta janë vendosur në pozita ku duhet të jenë punëtor me pozita të karrierës. Prej tyre 21 paguhen nga buxheti për paga dhe mëditje, përderisa 79 të tjerë paguhen nga subvencionet dhe transferet. Kontratat e tilla, vazhdohen çdo tre muaj.

Rreziku Mospërfillja e procedurave me rastin e angazhimit të stafit rrezikon punësimin e personave jokompetent për pozitat përkatëse. Kjo mund të rezultoj në mosefikasitet operacional si dhe në mosarritjen e objektivave të organizatës. Pagesat nga kategoria jo adekuate buxhetore ndikon në keqdeklarim të PVF-ve dhe mund të ndikoj në modifikimin e opinionit.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Këto angazhime duhet të zhvillohen konform ligjit mbi detyrimet. Angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se 6 muaj, dhe pagesa e tyre duhet të bëhet nga mallrat dhe shërbimet. Derisa pozitat e karrierës duhet të mbulohen me punonjës të rregullt konform ligjit për shërbimin civil, në bazë të procedurave të rregullta të konkursit publik.

Çështja 14 – Ushtrues detyre për kohë më të gjatë se sa parashihet me ligj – Prioriteti i mesëm

E gjetura Sipas Ligjit për shërbimin civil ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Ne kemi vërejtur se gjatë vitit 2015 në dy raste të ushtrimit të pozitave drejtuese është tejkaluar afati i përcaktuar me ligj. Kjo për arsye se procedurat e rekrutimit për këto pozita nuk ishin inicuar me kohë.

Rreziku Mbulimi i pozitave kyçe nga ushtrues detyre më gjatë se afati i paraparë ligjor mund të rezultoj në performacë të dobët operacionale dhe rrjedhimisht mosarritjen e objektivave të Ministrisë.

Rekomandimi 14 Në rastet e paraqitjes së pozitave të lira Ministri duhet të sigurojë fillimin sa më të hershëm të procedurave të duhura të rekrutimit për tju shmangur mbatjes së pozitave me UD përtej kohës së lejuar.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Ministria përveç që ndan subvencione për të financuar aktivitetet bazë të Institucioneve vartëse, ajo mbështet edhe financimin e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

Ministria kishte miratuar një rregullore për menaxhimin e subvencioneve, por ajo është vetëm një dokument i përgjithësuar, i cili nuk i specifikon kriteret për dhënie e subvencioneve, nuk i rregullon procedurat për raportimin e përfitueseve, për monitorimin e tyre dhe as veprimet e mundshme ndaj përfituesve të papërgjegjshëm. Kjo, ka bërë që dhënia dhe arsyetimi i subvencioneve të mbetet edhe më tej një fushë me probleme të theksuara dhe që kërkon vëmendje të veçantë nga menaxhmenti.

Çështja 15 –Përcaktimi i përfituesve dhe dhënia e subvencioneve - Prioritet i lartë

E gjetura Zbatimi jokonsistent i kërkesave ligjore dhe rregullores së brendshme për subvencionet kishte rezultuar në*:*

- *Aprovim të subvencionit pas mbajtjes së aktivitetit* – Në 5 raste[6] vendimet për subvencionim dhe pagesa e tyre ishin bërë pas përfundimit të projekteve të subvencionuara.
- *Mbyllje/arsyetim me vonesë e subvencionit* – Me vendim të Ministrit ishte mbështetur projekti "Bienalja e Venedikut" me 59,200€. Mirëpo nuk kishte një marrveshje formale në mes të Ministrisë dhe bartësit të projektit, për të përcaktuar qartë pergjegjësitë për raportim. Si rezultat

[6] Federata e Hendbollit ,20,209€; Federata e autosportit, 11,815€, Albulena Bilalli, 1,097€; Ilaz Hysaj 3,800€ dhe OJQ "Dera e hapur" ,7200€.

arsyetimi i projektit ishte bërë në vitin 2016 edhe pse aktiviteti është mbajtur në pjesën e parë të vitit 2015.

- *Mbështetje e projekteve në mospërputhje me programin e punës* - ishin subvencionuar 5 projekte[7] të ndryshme në vlerë prej 7,559€, të cilat nuk përkonin me natyrën dhe programin e punës së Ministrisë.
- *Vendimi për Subvencionim pa kërkesë drejtuar Ministrisë*- ishte mbështetur një student i Fakultetit të Arteve me 2,500€, për realizimin e shfaqjes së diplomës mirëpo vendimi ishte marrë në bazë të një kërkese për subvencion e cila i ishte drejtuar Komunës së Prishtinës.

Rreziku Dhënia e subvencioneve në kundërshim me rregullat dhe programin e ministrisë ndikojnë në menaxhim jo të mirë të buxhetit dhe mund të shkaktojë përdorimin e fondeve në kundërshtim me synimet e planifikuara.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të siguroj që me rastin e dhënies së subvencioneve të respektohen rregullat dhe kriteret, dhe të mos jepen subvencione të cilat nuk janë në harmoni me planin dhe natyrën e punës së Ministrisë.

Çështja 16 – Mosrealizimi i projekteve sipas marrëveshjeve- prioritet i lartë

E gjetura Mosrespektimi i marrëveshjeve për subvencionim nga ana e përfituesve ka rezultuar me

- *Mos mbajtje të aktivitetit*– një grup muzikor ishte mbështetur me 7,000€ për mbajtjen e dy koncerteve, dhe vetëm njëri nga koncertet ishte realizuar.
- *Mosrespektim i kushteve të kontratës* – Ishte paguar kësti i dytë i projektit për trajnime në vlerë 47,352€, pa u arsyetuar kësti i parë (edhe pse në kontratë specifikohej se kusht për tu paguar kësti i dytë, është arsyetimi i kështit të parë me dëshmi relevante). Më tej, nuk ishin respektuar kushtet e kontratës pasi që trajnimet nuk ishin mbajtur nga kompania fituese por ishte nënkontraktuar një kompani e tretë. Tek e njëjta, faturat në vlerë 17,820€ të sjellura si dëshmi për ushqim dhe pije ishin të mbivlerësuara.
- *Pagesa që tejkalojnë vlerën e projektit* – ishte financuar udhëtimi i një grupi artistik me qëllim të pjesëmarrjes në një aktivitet ndërkombëtar. Megjithatë për këtë udhëtim ishin paguar shtesë 6,854€, për biletat e reja të aeroplanit, për shkak të mos arritjes të disa pjesëmarrësve në aeroport me kohë.

[7] Albulena Bilalli, 1,097€ - Trajnimi në lëminë e grafikës në Universitetin e Arteve në Londër; D.P.H. "Jeta Food", 395€ - mbulimi i shpenzimeve për ushqim dhe pije në aktivitete humanitare ; Koleegji AAB, 2,452€ - Konferenca ndërkombëtare për arkitekturë ; OJQ EIS, 500€ - Ofrimi i mënyrës më të lehtë në të mësuarit, edukimit dhe informimit për fëmijët dhe OJQ Liria, 3,115€.-Pjesëmarrje në konferencë botërore për mjedis të pastër

- *Mosrespektim i kritereve të projektit* - Në tri raste të lidhura me shërbime të trajnimeve me vlerë 153,132€, trajnimet janë mbajtuar nga trajnues tjerë dhe jo nga ata të cilët ishin paraqitur në ofertë. Ky ka qenë një ndër kriteret për përzgjedhjen e kompanisë fituese. Nuk ka dëshmi që tregojnë se për këtë ndryshim kontraktuesi ka marrë aprovimin e Ministrisë/departamentit.

Rreziku Mos realizimi i projekteve sipas marrëveshjeve mund të ndikoj që projektet të mos e arrijnë qëllimin e synuar. Mbajtja e trajnimeve nga trajner të tjerë nga ata të vlerësuar në ofertë mund të ndikoj që trajnimet të mos jenë të kualitetit që është kërkuar.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të sigurojë që realizimi i projekteve të subvencionuara të monitorohet në vazhdimësi për të siguruar respektimin e marrëveshjeve dhe raportimin për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Kjo do të siguronte që qëllimet e synuara me rastin e dhënjes së subvencioneve janë arritur.

Çështja 17 Mosarsyetim adekuat i subvencioneve të përfituara- prioritet i lartë

E gjetura Dhënia e subvencioneve nga MKRS ka për qëllim realizimin e projekteve të kulturës, rinisë, të sportit dhe të trashëgimisë kulturore. Pas përfundimit të këtyre mjeteve përfituesit pritet që shpenzimin e mjeteve të përfituara ti arsyetojnë me dorëzimin e dëshmive të dokumentuara. Megjithatë kjo nuk po ndodh me projektet e financuara nga MKRS-ja për arsye të ndryshme. Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se:

- Si pasojë e menaxhimit jo të mirë të procesit të dhënies së subvencioneve si dhe mungesës së mekanizmave adekuat që do ti kushtëzonte përfituesit që të raportojnë për projektet e subvencionuara, një numër i konsiderueshëm i avanceve/projekteve të subvencionuara nga vitet paraprake në vlerë prej mbi 6 milion euro kanë mbetur të paarsyetuara.
- Mungesë e dëshmive relevante - Te projekti për ofrimin e trajnimit falas për 200 të rinjë në vlerë 39,130€, mungonin dëshmitë relevante për pagesat/transferet bankare. Si dëshmi ishin sjellë fatura me datë më të hershme se sa datat e realizimit të projektit dhe disa paragon blloqe. Poashtu në bazë të raportit të bartësit të projektit vetëm 89 persona kanë marrë pjesë në këto trajnime, derisa shpenzimet janë mbuluar për 200.

Rreziku Numri i madh i projekteve të paarsyetuara bën të pamundur konfirmimin nëse objektivat e Ministrisë janë arritur. Mosarsyetimi dhe mos raportimi për projektet e subvencionuara, dëmtojnë menaxhimin e buxhetit dhe mund të shkaktojnë përdorimin e fondeve në kundërshtim me synimet e planifikuara.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të siguroj që projektet e subvencionuara të jenë subjekt i monitorimit të rregullt nga zyrtarët e Ministrisë, për të siguruar respektimin e kërkesave/afateve për raportim nga përfituesit për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Aty ku nuk respektohen kërkesat dhe afatet kohore për arsyetimin e shpenzimeve duhet të ndërmerren masat e nevojshme ndëshkuese.

Çështja 18 Subvencionimi i OJQ-ve – Prioriteti i mesëm

E gjetura Në dy raste, Ministria kishte subvencionuar OJQ-të duke derdhur mjetet në llogari private të personave dhe jo të OJQ-ve. Shuma e tyre ishte 6,800€, derisa arsyetimet e shpenzimeve nuk ishin relevante[8].

Në pesë raste me vlerë 7,755€[9], Ministria kishte përzgjedhur OJQ–të si përfitues të subvencioneve përkundër faktit se nuk i kishin respektuar kriteret e thirrjes për aplikim. Realizimi i projekteve të subvencionuara nuk ishte monitoruar për tu siguruar se mjetet po shpenzohen për qëllimin e caktuar.

Rreziku Derdhja e mjeteve në llogari private me rastin e subvencionimit është në kundërshtim me rregullat dhe mund të rezultojë me keqpërdorim eventual të mjeteve. Subvencionimi pa kritere dhe mungesa e monitorimit të shpenzimit të këtyre mjeteve nga ana Ministrisë mund të rezultojë në mosarritjen e qëllimit të subvencioneve.

Rekomandimi 18 Ministri duhet të sigurojë që realizimi i projekteve të OJQ-ve që financohen nga Ministria të monitorohet në baza të rregullta për të siguruar se qëllimet e synuara janë arritur dhe shpenzimet janë arsyetuar me dëshmi relevante.

Çështja 19 – Shpenzim i mjeteve nga institucionet vartëse të Ministrisë – Prioriteti i lartë

E gjetura MKRS financon aktivitetet dhe projekte të ndryshme të Institucioneve vartëse të saj. Andaj ne kemi testuar se si menaxhojnë me mjetet financiare disa nga institucionet vartëse. Testimet e kryera kanë rezultuar me të gjeturat në vijim:

Tek Filharmonija e Kosovës janë identifikuar mangësitë në vijim:

- Në mungesë të një rregullore për kompenzimin e stafit të brendshëm të angazhuar në projekte, lartësinë e shumës së kompenzimit e vendos

[8] Fatmir Selimi 3,000€;Ilaz Hysaj 3,800€
[9] OJQ Dardana Pres 1,595€; OJQ Grupi Llausha 1,820; OJQ Ndryshe 1,270; OJQ Prehja 1,340; dhe OJQ Tradita 1,730.

Drejtori i Filharmonisë. Më tej, kompenzimi bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe nuk ndalet tatimi në të ardhura;

- Pagesat e solistëve të huaj të angazhuar në projekte bëhen me para në dorë, dhe nuk ka ndonjë dëshmi të pranimit të parave nga ana e tyre; dhe
- Me rastin e manifestimit të 100 vjetorit të lindjes së Nënës Terezë, dirigjenti i angazhuar ishte paguar dy herë për të njëjtin angazhim. Një herë nga Filharmonija dhe një herë nga bartësja e projektit. Vlera e mbipagesës ishte 2,000€. Përveq kësaj, mjetet nuk ishin derdhur në llogarinë personale të dirigjentit por me para në dorë.

Këto çështje janë paraqitur si rezultat i menaxhimit të dobët të projekteve dhe mungesës së një rregullore për kompensimin e të angazhuarve.

Në Teatrin Kombëtar të Kosovës janë vërejtur mangësitë në vijim:

- Për realizimin e shfaqjeve janë angazhuar aktorë të jashtëm, derisa stafi i rregullt që paguhet për atë punë, nuk janë angazhuar fare në shfaqje. Kjo shkakton shpenzime të dyfishta; dhe
- Për realizimin e shfaqjes "Shopping and Fucking" në vlerë 28,481€, TKK kishte lidhur kontratë me një person për një pozicion të caktuar të projektit, ndërsa kontrata ishte bërë në cilësinë e emrit të tij artistik (DJ Alexander) dhe jo të personit fizik.

Në Institutin Arkeologjik i Kosovës (IAK) janë identifikuar mangësitë në vijim:

- Vlera totale e projekteve të IAK të financuara nga MKRS ishte 565,142€. Disa nga projektet janë klasifikuar si subvencione dhe transfere e disa tjera si investimeve kapitale varësisht nga kohëzgjatja e projektit. Mirëpo nuk ka një bazë të qartë dhe të arsyeshme për klasifikimin e këtyre projekteve; dhe
- Pjesa më e madhe e mjeteve të projekteve të IAK shpenzohet për pagesën e stafit që punon në realizimin e projekteve të IAK (gërmime arkeologjike). Nuk ka ndonjë procedurë të përcaktuar për përzgjedhjen e këtij stafi. Derisa për disa të angazhuar mungojnë dëshmitë mbi kualifikimet e tyre. Poashtu, mungojnë dëshmitë për kryerjen e punëve ndërsa kontratat janë nënshkruar pas përfundimit të punëve.

Rreziku Mangësitë në menaxhimin e proceseve dhe të shpenzimeve të Institucioneve vartëse si dhe mungesa e rregulloreve/udhëzimeve për angazhimin e punëtorëve, e zvoglojnë efikasitetin dhe e rrezikojnë arritjen e objektivave të projekteve të caktuara dhe të Ministrisë në përgjithësi. Pagesat e dyfishta, pagesat me para në dorë si dhe pagesat në mungesë të dëshmive për punën e kryer dëmtojnë transparencën dhe llogaridhënien dhe paraqesin shpenzime të parregullta.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të punojë ngushtë me këshillat drejtues të institucioneve vartëse me qëllim që të hartojnë një rregullore gjithëpërfshirëse për angazhimin dhe pagesën e stafit për projekte të ndryshme, e cila në mënyrë të qartë do të përcaktojë procedurën e angazhimit dhe të kompensimit. Duhet të zbatohen kontrolle të përmirësuara për të siguruar që të gjitha kompenzimet e të angazhuarve të jashtëm të jenë të dokumentuara dhe të bëhen përmes llogarisë bankare.

Çështja 20 – Pagesat nga subvencionet për kategori tjera të shpenzimeve – Prioriteti i lartë

E gjetura *Pagesa e punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta* - nga subvenionet dhe transferet janë paguar paga dhe kontribute në vlerë 249,313€, për të angazhuarit me marrëveshje për shërbimet e veçanta. Sipas ministrisë kjo ishte bërë në mungesë të mjeteve të mjaftueshme financiare në kategorinë përkatëse. Megjithatë ne theksojmë faktin se marrëveshjet mbi shërbimet e veçanta rregullohen me Ligjin mbi detyrimet, dhe angazhimi në bazë të këtyre marrëveshjeve nuk llogaritet përvojë pune. Këto lloj marrëveshjesh nuk mund të zgjasin më shumë se 6 muaj dhe kompensimi bëhet nga mallrat dhe shërbimet.

Në dhjetë raste në vlerë prej 9,600€, nga subvencionet ishin paguar punëtorë të Ministrisë për hartime dhe mbikqyrje të projekteve dhe kryerjen e punëve si anëtarë të këshillave drejtues. Përveç kësaj, shumat në të cilat ishin bazuar pagesat për hartuesit dhe mbikqyrësit e projekteve nuk kishin bazë ligjore.

Këto çështje janë ngritur si rezultat i rregullores së mangët të subvencioneve dhe moszbatimit të saj nga ana e Ministrisë.

Rreziku Pagesat nga buxheti i subvencioneve për kategori tjera të shpenzimeve shkaktojnë menaxhim të dobët buxhetor dhe raportim të gabueshëm financiar. E gjithë kjo rezulton në përdorimin e fondeve në kundërshtim me synimet e planifikuara dhe keqklasifikim të shpenzimeve në PF.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të vendos kontrolle buxhetore më të forta dhe të sigurojë që shpenzimet bëhen në përputhje me qëllimin dhe planifikimin e tyre në mënyrë që të sigurohet shpenzim adekuat i buxhetit dhe klasifikim i duhur i shpenzimeve.

Çështja – 21 Çështje tjera në lidhje me subvencionet – Prioriteti i mesëm

E gjetura

Përveç çështjeve të ngritura më lartë ne kemi identifikuar edhe çështjet si më poshtë:

Mungesë e kërkesave dhe autorizimeve për pagesë - Kompanisë "Altavia travel"i janë paguar 41,743€ në emër të subvencionimit të udhëtimeve të disa zyrtarëve të Ministrisë dhe federatave të sportit. Në dosjet e pagesave mungonin kërkesat nga Federatat dhe autorizimet për pagesë nga Drejtoria përkatëse.

Nënshkrim i marrveshjeve - Në tri raste marrëveshjet në vlerë 153,132€, ishin nënshkruar nga Drejtori i departmentit, mirëpo ne nuk kemi marrë dëshmi se është marrur paraprakisht aprovimi nga Ministri (kjo kërkohet me rregulloren e brendshme) Për më tepër në tri rastet, MKRS kishte nënshkruar kontrata të shtrenjta për trajnime përkundër faktit se kishte ofertues të cilët ofertonin me çmime më të lira për të njëjtat trajnime. Në katër raste të tjera në vlerë 11,019€, ato ishin nënshkruar nga Zyrtarë të departamenteve të Ministrisë. Nuk ka dëshmi për të vërtetuar që ata persona janë autorizuar për të nënshkruar këto marrëveshje.

Rreziku

Realizimi i pagesave në mungesë të dëshmive rreth kërkesave dhe autorizimeve mund të rezultojë në pagesa të parregullta. Nënshkrimi i kontratave nga persona jokompetent mund të rezultojë me kontrata potencialisht jo valide dhe mosarritje të qëllimit të subvencionit. Kontraktimi i shërbimeve me ofertues më të shtrenjtë mund të rezultojë me shpenzim joracional të buxhetit dhe në mosarritje të vlerës për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi 21

Ministri duhet të sigurojë që të gjitha pagesat janë të mbështetura me dëshmi komplete, përfshirë kërkesat dhe aprovimet e nevojshme. Të gjitha marrëveshjet për subvencionim të nënshkruhen nga persona kompetent. Një rishikim i kontratave më të shtrenjta se sa ofertat tjera konkuruese është i nevojshëm për të përcaktuar arsyet, duke marrë parasysh se këto projekte nuk janë zbatuar sipas marrëveshjeve.

3.6 Të Hyrat

Ministria realizon të hyra nëpermjet Institucioneve vartëse të saj. Të hyrat e realizuara në 2015 ishin në vlerë 39,463€. Këto të hyra kanë të bëjnë më të hyrat nga participimet në aktivitetet kulturore, nga Departmenti i Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore si dhe Bibliotekës Kombëtare.

Çështja 22 – Menaxhimi i të hyrave nga Ministria dhe institucioneve vartëse – Prioritet i mesëm

E gjetura

Menaxhimi i evidencave në lidhje me të hyrat e realizuara nuk ishte menaxhuar mirë ngase:

- Të hyrat e realizuara nga Institucionet vartëse nuk ishin raportuar me kohë në Ministri dhe nuk janë deponuar në bankë sipas kërkesave dhe udhëzimeve të Thesarit. Kjo ka ndodhur te Bibloteka Kombëtare, Teatri Kombëtar dhe IMM Prizreni, ku të hyrat nuk janë raportuar me rregull dhe nuk janë deponuar në bankë sipas kërkesave të udhëzimeve përkatëse.
- Këto çështje kanë ndodhur sepse rregulloret relevenate nuk janë respektuar dhe ka munguar bashkëpunimi i mirëfilltë ndërmjet Ministrisë dhe Institucioneve vartëse.

Rreziku

Të vepruarit në kundërshtim me rregullat qeveritare në lidhje me të hyrat shkakton menaxhim joefektiv te të hyrave dhe njëherit ndikon në menaxhimin e dobët të aktiviteteve në kuadër të Ministrisë. E gjithë kjo mund të dërgoj në shfrytëzimin joadekuat të burimeve financiare dhe rrezikon keqpërdorimin e parasë publike.

Rekomandimi 22

Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm, që mbështet mbledhjen, evidentimin, barazimin dhe raportimin e të hyrave. Të konsiderohet mundësia që duke u bazuar në rregullat e përgjithshme, të krijohen udhëzues praktik për menaxhimin/raportimin e të hyrave nga ana e institucioneve vartëse, për të siguruar që paratë publike po menaxhohen në menyrë të drejtë dhe efikase si dhe të zvoglohen mundësitë e keqpërdorimit eventual të tyre.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Megjithëse ministria kishte bërë përparime sa i përket identifikimit të objekteve dhe pronave të saj, duke formuar një komision për këtë çështje, regjistri i pasurisë, ende nuk paraqet pasuritë totale, si i tillë është jo i besueshëm. Kjo pasi që puna e komisionit ende nuk ka përfunduar dhe nuk dihet vlera e saktë e këtyre pronave. Më tej, komisioni për inventarizim nuk kishte një raport të përfunduar për ta pasqyruar gjendjen reale të pasurisë në PVF-të e 2015.

Gjendja e pasurisë kapitale në vitin e kaluar ishte 10,978,133€, ndërsa vlera e pasurisë në fund të vitit 2015 në PVF është rritur në 12,698,096€.

Çështja 23 – Ministria nuk kishte bërë inventarizimin e pasurisë me kohë- Prioritet i lartë

E gjetura

Megjithëse ishte formuar komisioni për invertarizimin e pasurive të Ministrisë në fund të vitit, ai nuk kishte përfunduar punën me kohë, dhe puna e tij nuk ishte bërë në përputhje me kërkesat e UA 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare. Mungonte ndërlidhja/krahasimi i shënimeve nga raporti i invertarizimit dhe zyrtarës së pasurisë. Si të tilla, shënimet e prezantuara në PVF lidhur me pasuritë janë materialisht të pasakta;

E-pasuria nuk shfrytëzohet siç duhet për menaxhimin e pasurisë nën 1,000€, dhe menaxhimi i materialit shpenzues bëhet përmes listave në depo.

Rreziku

Mungesa e kontrolleve në menaxhimin e pasurisë dhe mos regjistrimi i saj sipas rregullave mund të shpie në humbjen, keqpërdorimin dhe përdorimin e paautorizuar të tyre. Mos regjistrimi i të gjitha pasurive ndikon në cilësinë e shënimeve të shpalosura në PVF.

Rekomandimi 23

Ministri duhet të sigurojë që komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë në mënyrë që vlera e pasurive e pasqyruar në PVF të jetë e plotë dhe e saktë. Nevojiten aktivitete të shtuara në përfshirjen e të gjitha pasurive në regjistrat kontabël, përfshirë pasuritë e Institucioneve vartëse.

3.7.2 Trajtimi i borxheve

MKRS nuk ka kontrolle të mjaftueshme në menaxhimin e obligimeve të papaguara. Detyrimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit ishin 219,597€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Ministria nuk ka aplikuar një proces të mirëfilltë të mbledhjes së faturave të të papaguara dhe kjo ka rezultuar në mosnjohje të obligimeve dhe mospagesë të tyre me kohë.

Çështja 24 - Menaxhim joefektiv i obligimeve të papaguara - Prioritet i lartë

E gjetura

Nga pagesat e vitit 2015 për faturat e viteve të mëparshme, kemi konfirmuar se Ministria nuk i kishte shpalosur të njëjtat në PVF-të e vitit 2014 si obligime të papaguara në vlerë 533,453€.

Pagesa në vlerë 46,717€ ishin ekzekutuar nga ana e Thesarit si rezultat i mosnjohjes dhe pagesës me kohë të këtyre obligimeve nga ana e Ministrisë.

Rreziku

Mungesa e një procesi të mirëfilltë të mbledhjes/raportimit të obligimeve do të shpie në mospagesë të tyre me kohë dhe mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit e mospërmbushje të objektivave, pasi pagesa të tjera mund të ekzekutohen nga Thesari në çdo kohë.

Rekomandimi 24

Ministri duhet të sigurojë që të bëj një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, të bëj një vlerësim të menjëhershëm të borxheve dhe të marrë masa adekuate për përmirësim të gjendjes aktuale.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të siguroj që procesi i prodhimit të PVF-ve të përfshin një rishikim të detajuar të draft PVF-ve nga ana e Menaxhmentit para se Pasqyrat të dërgohen në Thesar. Fokusi kryesor duhet të jetë në fushat me rrezik të lartë dhe ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet nëse nuk janë implementuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		PVF-të e 2015 ishin korrigjuar për disa zëra dhe disa shpalosje, mirëpo nuk janë marrë veprime në lidhje me shpalosjen e drejtë të të gjitha zërave në PVF.	
Rreziqet domethënëse në PFV	Ministri duhet të siguroj që të hartohet një regjistër gjithpërfshirës i pasurive i cili do të paraqes një pasqyrë e plotë dhe të saktë të e pasurive të Ministrisë dhe kjo të reflektohet në PVF-të e vitit 2015.		Ishin ndërmarrë disa veprime, megjithatë regjistri gjithpërfshirës i pasurive, ende nuk paraqet një pasqyrë reale të pasurive.	
Rreziqet domethënëse në PF	Ministri duhet të shqyrtoj shkaqet që po ndikojnë që transferimi i mjeteve tek institucionet vartëse të përsëritet vit pas viti dhe të identifikoj/ndërmerr veprimet që kjo të mos përsëritet në të ardhmën.	Rekomandimi është implementuar.		

Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që një plan i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Rekomandimet që nuk implementohen brenda afateve të pritshme kohore duhet të shqyrtohen formalisht nga Ministri dhe të merren veprime proaktive për t"i adresuar arsyet e raportuara për vonesat e implementimit.		Ishin marrë masa, pasi që disa rekomandime të dhëna janë implementuar apo kanë filluar të adresohen, mirëpo shumica e tyre nuk ishin implementuar.	
2.5.Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri në bashkëpunim me Udhëheqësit e Institucioneve vartëse të bëjnë një rishikim të çështjeve të identifikuara, për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe për të përcaktuar masat e nevojshme për të futur në zbatim një raportim financiar të rregullt dhe cilësor. Rolet dhe pergjegjësitë e Ministrisë dhe të institucioneve në këtë proces duhet të qartësohen.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit.
3.3.Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri të siguroj që përgatitja e buxhetit është paraprirë nga një proces i vlerësimit që reflekton të gjitha informatat relevante, përfshirë realizimet e viteve të kaluara dhe ndryshimet e pritura në vitin e ardhshëm. Poashtu duhet të monitorojë performancën buxhetore në baza mujore, që të identifikohen dhe adresohen barrierat që shkaktojnë vështirësi në realizimin e buxhetit.		Ishin ndërmarrë masa në adresimin e rekomandimit sa i përket realizimit të buxhetit, mirëpo nuk ishin ndërmarrë veprime sa i përket trendit të shpenzimeve.	
4.4 Te hyrat	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm, që mbështet mbledhjen, evidentimin, barazimin dhe raportimin e të hyrave. Dhënia në shfrytëzim e hapësirave të Institucioneve vartëse të bëhet nëpërmjet një procesi transparent tenderues.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit.

3.4.Prokurimi – Dobësitë sistematike	Ministri duhet të inicoj urgjentisht analiza për arsyet prapa dobësive sistematike të identifikuara. Analizat duhet të identifikojnë ndërmarrjën e masave të nevojshme dhe duhet të finalizohen deri në tetor 2015.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit.
3.4.Prokurimi – Dobësitë josistematike	Ministri duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar që situata të tilla nuk do të përsëriten.	Rekomandimi është implementuar.		
3.5.2.Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë që pagesat për punë shtesë të realizohen vetëm pas kërkesës për pagesë dhe të kompletuara me dokumentet e nevojshme.			Nuk ishin marrë masa për implementimin e rekomandimit.
3.5.2.Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të inicojë një rishikim gjithpërfshirës të stafit të rregulltë dhe të angazhuar me kontrata për të përcaktuar saktë nevojat për staf të Ministrisë dhe Institucioneve vartëse, dhe të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt, përmes procesit të hapur të rekrutimit.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit.
3.5.2.Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të inicojë një rishikim të hollësishëm të menaxhimit të pagave dhe kompensimeve për të gjetur shkaktarët e këtyre mbipagesave dhe të siguroj përforcimin e kontrolleve në ketë fushë, për të mundësuar që listat e pagave azhurnohen rregullisht dhe të reflektojnë vijueshmërinë në punë. Punët jashtë orarit duhet të planifikohen dhe kompenzohen pasi të aprovohen fillimisht nga mbikqyrësi, pastaj nga ZKA.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit.

3.5.2.Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë që procedurat e kërkuara të avancimit dhe të rekrutimit janë aplikuar konform rregullave dhe të rrit kontrollet e brendshme duke siguruar që rregulloret relevante janë respektuar me konsistencë në të gjitha rastet.		Ishin ndërmarrë masa sa i përket adresimit të rekomandimit në lidhje me avancimet e stafit, mirëpo jo ne lidhje me kohëzgjatjen e UD-ve	
Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të siguroj që proceset e rekrutimit të sigurojnë se personat meritor po pranohen në punë duke reflektuar saktë objektivat e Organizatës.	Rekomandimi është implementuar.		
Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë se kategoria e subvencioneve do të përdoret vetëm për qëllimet e saj. Klasifikimi i rregulltë i shpenzimeve do të jetë prioritet i Ministrisë për shkak të rëndësisë që ka klasifikimi i saktë për PVF. Poashtu Ministri duhet të sigurojë se procesi i prokurimit nuk do të jetë i fokusuar vetëm në arritjën e kërkesave ligjore, por të sigurojë proces efektiv të prokurimit. Procesi i buxhetimit të saktë duhet të forcohet dhe bashkëpunimi në mes departmenteve respektive të zhvillohet në mënyrë që sigurohen aktivitetet e planifikuara në kategorinë/kodin e saktë.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit
Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të siguroj që projektet e subvencionuara të jenë subjekt i monitorimit të rregullt, për të siguruar respektimin e kërkesave/afateve për raportim të përfituesve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Aty ku nuk respektohen kërkesat dhe afatet për arsyetimin e shpenzimeve duhet të ndërmerren masat e nevojshme ndëshkuese.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit

Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet që të angazhoj një grup punues për përpilimin e një rregullore gjithëpërfshirëse për pagesën e aktorëve dhe stafit tjetër të angazhuar në shfaqje i cili në mënyrë të qartë do të përcaktojë kush mund të paguhet dhe bazën për secilën pagesë të bërë. Duhet të zbatohen kontrolle të përfocuara për të siguruar që vetëm pagesat e dokumentuara dhe të mbështetura me informata të nevojshme dhe mjaftueshme të realizohen.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit
Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të shqyrtoj rastet e lartëpermendura për t"i hetuar shkaqet pse pagesat janë bërë pa dëshmi të mjaftueshme dhe jo në bazë të procedurave të pritshme të prokurimit. Kontrollet e duhura dhe mbikqyrja duhet të futen dhe të mbështeten me rregullore të nevojshme për të siguruar që prokurimi i duhur dhe procedurat e duhura të pagesave janë zbatuar në të ardhmën.	Rekomandimi është implementuar.		
Subvencionet dhe Transferet	Ministri në bashkëpunim me Departmentet përkatëse dhe mbështetjën e zyrës së financave duhet të shqyrtojnë kërkesat e sakta buxhetore të cilat reflektojnë nevojat reale të Departmenteve. Përkrahja financiare e projekteve duhet të përcillet përmes procedurave përkatëse të autorizimit dhe monitorimit duke siguruar se objektivat e shpenzimeve të kësaj fushe janë arritur.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit
Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë që komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë. Zyrtari për menaxhim të pasurisë duhet të regjistrojë dhe mirëmbajë regjistrat e pasurisë sipas Rregullores 02/2013 për menaxhim të pasurisë jo financiare			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit

Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të siguroj që të gjitha projektet kapitale të financuara nga Ministria të evidentohen si investime në vijim, të shoqëruar me një plan me detajet dhe datat e transferit, përfituesit, kostos, etj. Në bashkëpunim me MF duhet të shqyrtohet mundësia e korigjimit të shënimeve në SIMFK për të pasur pasqyrë reale të pasurive. Ato duhet të shpalosen edhe në PVF konform standardeve të kontabilitetit dhe rregullave të menaxhimit të pasurive.	Rekomandimi është implementuar.		
	Ministri duhet të kryej një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e dala nga rregullat për menaxhimin e veturave zyrtare nuk janë aplikuar, dhe të përcaktojë masat e nevojshme që kjo gjendje të mos përseritet.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit
Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të ndërmerr një rishikim të linjave të raportimit të obligimeve dhe një vlerësim të menjëhershëm të borxheve, për të përcaktuar masat adekuate për përmirësimin e gjendjës aktuale. Pagesat duhet të ekzekutohen sipas vjetërsisë së obligimeve në mënyrë që Ministria të mos jetë subjekt i padisë nga operatorët ekonomik.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit
Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të sigurojë që Sistemi i Auditimit të Brendshëm të funksionalizohet më shumë. Është e nevojshme të monitorohet përmbushja e planit të NjAB në baza tremujore dhe të ndërmerren veprime proaktive në mënyrë që çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm të adresohen në kohën e duhur. Përveç kësaj, KA duhet të ri-aktivizohet duke i dhënë mbështetje menaxhmentit dhe NJAB në implementimin adekuat të rekomandimeve.			Nuk ishin ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimit